



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 31.05.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 30.05.2022, të parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik Haris Karameta B.I.; Osman Zymberi B.I.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve Komunale-Ritenderim”** me Nr. të Prok: 613 022 025 221.

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e **Grupit të Operatorëve Ekonomik Haris Karameta B.I.; Osman Zymberi B.I.**, të dt. 30.05.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve Komunale-Ritenderim”**, me nr. të Prok: 613 022 025 221.

Vërtetohet Vendimi i AK për shperblim me kontrate për **Grupin e Operatorëve Ekonomik CAPITAL X FET SH.P.K.; ROSI TRADE SHPK** nga Klina, i datës 26.05.2022, të publikuar në web-faqe të KRPP-së. Mbetet në fuqi Vendimi i AK për shperblim me kontrate i publikuar me datë: 26.05.2022.

1. Autoriteti kontraktues vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit të lartepërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grupi i Operatorëve Ekonomik Haris Karameta B.I.; Osman Zymberi B.I., me datë 30.05.2022, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve Komunale-Ritenderim”** me nr. të Prok: 613 022 025 221, ku në këtë aktivitet AK ka shpallur fitues **Grupin e Operatorëve Ekonomik CAPITAL X FET SH.P.K.; ROSI TRADE SHPK** nga Klina për shperblim me kontrate të dates date: 26.05.2022, të publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.


Komisioni vleresues gjate vleresimit te tenderit juaj ka konstatuar qe ju nuk i plotesoni kerketat te cilat jane te vendosura ne njoftim per kontrate dhe dosje te tenderit, dhe ne perputhje me nenin 72 dhe nenin 59 te LPP-se, kemi kerkuar sqarime shtese me date 19.05.2022, dhe me date 20.05.2022 jeni pergjigjur dhe keni ofruar dokumentacione shtese te cilat sipas Autoritetit Kontraktues nuk arrijne te mbulojne kerketat te cilat ne i kemi kerkuar nga ju ne letren standarde te kerkeses per sqarim te tenderit.

AK, konsideron se tenderi juaj është vlersuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Bekim Shabani

Drejtör i Prokurimit